



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Periudha raportuese	Shkurt 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Heroina Maloku

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Sa i përket Drejtorisë së Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, gjatë periudhës raportuese, shkurt 2016, mbarëvajtja e punëve ka shkuar në mënyrë të njëjtë sikurse muajt e kaluar, edhe pse në aspektin e pranimit të lëndëve në krahasim me muajin janar, gjatë këtij muaji kemi rritje pothuajse të dyfishtë.

Në Sektorin e urbanizimit, muaji shkurt ka shënuar vijimin e aktiviteteve të planifikuara. Kanë vazhduar takimet e Grupit profesional- Kolegjiut, me qëllim të diskutimit dhe gjetjes së zgjidhjeve të lëndëve. Ka vazhduar puna në unifikimin e formave të kushte ndërtimore, letrave informatave, pëlqimeve të ndryshme, lejeve ndërtimore, formës së refuzimit dhe dokumenteve të tjera që lëshohen nga kjo drejtori, si dhe është ripunuar ueb-faqja e Drejtorisë.



Gjatë këtij muaji janë pranuar 104 kërkesa të ndryshme, pra ka qenë thuajse trend i njëjtë me muajin e kaluar sa i përket kërkesave derisa është rritur numri i shqyrtimeve.

Janë caktuar kushte për 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa, prej të cilave 10 (dhjetë) për objekte të kategorisë I dhe të tjerat të kategorisë II, janë dhënë 10 (dhjetë) leje ndërtimi, prej të cilave 4 (katër) janë për ndërtesë shumëkatëshe, ndërsa të tjerat shtëpi individuale, janë dhënë 11 (njëmbëdhjetë) vendime - pëlqime të ndryshme, ku 8 (tetë) janë për pronë, ndërsa të tjerat për renovime ose punë ndërtimore, janë refuzuar 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa, si dhe shumë informime për plotësim dokumentacioni, aktvendime kompensimi e të ngjashme.

Të dhëna statistikore për Sektorin e urbanizimit:

<i>Lëndët e pranuarra - shkurt</i>	Kushte ndërtimore	Leje ndërtimore	Konstatime për refuzim	Vendime-pëlqime	Lëndë në procedurë
104	17	10	17	11	165

Krahasimi me muajin janar:



Është realizuar takimi i punës për kriteret e legalizimit, ku pjesëmarrës ishin stafit i Urbanizmit, në bashkëpunim me Sektorin e legalizimit. Ka vazhduar regjistrimi i lëndëve në Sistem të vrojtimit të lëndëve.

Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët kanë qenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme për mbikëqyrje të projekteve.

Grupi profesional ka realizuar mbi 50 takime me qytetarë të interesuar për konsulta para aplikimit për leje ndërtimi ose kushte ndërtimore, e sidomos për objektet e kategorisë II, të cilave u janë dhënë sqarimet, duke i udhëzuar për procedurë të mëtutjeshme. Sikurse edhe më herët, Probleme të identifikuar janë mos interesimi i pronarëve për t'u përfshirë me zgjidhje urbane në shumë raste nga një parcelë, të cilat pengonin zhvillimin e sipërfaqeve të mëdha të planifikuara për ndërtim.

Puna në Sektorin e planifikimit ka vazhduar me informata nga plani. Duhet theksuar fillimin e punëve në formimin e data-bazes në sistemin "Gis", që rezulton në mbledhjen e resurseve për hartimin e dokumentit të Hartës zonale të Komunës. Po ashtu, gjatë këtij muaji kanë filluar me hulumtime dhe mbledhje të materialit për konkursin e zonës "Qendra".

Zyra për rigjenerim urban gjatë këtij muaji, ka filluar me projektin ideor për park, me lokacion afër sallës "1 Tetori" në Prishtinë. Është duke u bërë edhe projekti për planifikimin e

parkingut te Pallati i Rinisë, projekti për funksionalizimin e fushave të tenisit në Gërmi, analiza e lokacionit në qendrën rekreative “Gërmia”.

- Dorëzimi i paramasës / parollojarisë për rrethojën në qendrën rekreative “Gërmia”;
- Dizajnimi i dyerve për hyrjet në qendrën rekreative “Gërmia”;
- Projektimi dhe dizajnimi i hapësirës për shumë qëllime (rrafshimi i terrenit, ndërtimi i tribunës);
- Projektimi dhe dizajnimi i hapësirës për lojë në oborrin e qendrës rekreative në Gërmi;
- Identifikimi i faktorëve që pengojnë në funksionimin e objektit (lagështia, myku, organizimi i hapësirave të tjera);
- Projektimi për oborrin e QMF-së në rr.”Fehmi Agani”.

Sa i përket Sektorit të legalizimit, gjatë muajit raportues kanë arritur 80 aplikime të reja dhe i kemi trajtuar edhe 46 lëndë të procesit të vitit 2010, ku gjithsej kemi trajtuar 126 lënde për legalizim. 9 ndërtime janë legalizuar, ndërkohë që tjerat duhet të bëjnë plotësime për ta kompletuar aplikacionin e tyre për legalizim.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj .

- Zbatimi i bazës ligjore për planifikim e ndërtim. Shqyrtimi i lëndëve duke respektuar afatet ligjore;
- Unifikimi i dokumenteve që lëshohen nga Sektori;
- Vlerësimi i lëndëve nga grupi profesional – kolegji, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
- Përpunimi i ueb-faqes së Komunës, sa i përket Drejtorisë;
- Takimet me qytetarë të interesuar për zgjidhjet urbane, deri në arritjen e zgjidhjes, dhe përgatitjet para aplikimit për kushte ndërtimore;
- Procedurat e miratimit të rregullores për taksën e re ndërtimore;
- Vazhdimi i punës për ndërtimin e data-bazës në sistemin “Gis”;
- Analiza e PZHK- së dhe PZHU-së;
- Detyra projektuese për konkursin e zones " Qendra 1 dhe 2 "- " Qendra ";
- Përgatitja e lëndëve arkivore deri në vitin 2008, për dorëzim në Arkivin Komunal;
- Përgatitja e Rregullores për taksë dhe tarifave për dhënien e lejes së ndërtimit;
- Perfundimi i projektit për tenderim tek parku “1 Tetori”.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Aktivitetet e implementuar gjatë periudhës raportuese:

- Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- Plotësimi i "Permit Tracking System" me lëndët e muajve në vijim;
- Publikimi i lejeve ndërtimore në ueb-faqen e Komunës;
- Mbikëqyrja e projekteve që realizohen nga investimet kapitale të Komunës;
- Pjesëmarrje në vlerësime të ofertave lidhur me punët ndërtimore për investimet e Komunës;
- Takimet e rregullta të zyrtarëve shqyrtues me grupin profesional - kolegjiun për lëndë konkrete;
- Takime të shumta me qytetarë për arritjen e zgjidhjeve urbane para kushteve ndërtimore;
- Përgjigje në kërkesa të ndryshme sa i përket punës së sektorit;
- Përgatitje për plotësim-ndryshimin e ueb-faqes së Komunës sa i përket DUNMM-së.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Aktivitetet në implementim e sipër për periudhën raportuese

Vazhdojmë me zbatimin e bazës ligjore, duke u përpjekur që të respektohen afatet ligjore:

- Pjesëmarrje në grupin punues të thirrur nga MMPH-ja, për plotësim-ndryshimin e Rregullores për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi dhe hapësirat në funksion të tyre, dhe grupi punues për plotësim-ndryshimin e UA për procedurat e aplikimit për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore.
- Vazhdon puna në përmirsimin e sistemit të informimit për monitorimin e procedurës për marrjen e lejes së ndërtimit nga qytetarët, si masë e transparencës;
- Po punohet në unifikimin e dokumenteve që lëshohen nga Drejtoria, si masë e funksionalizimit të skemës së re të ristrukturuar të stafit;
- Po punohet në rritjen e efikasitetit të punës së grupit profesional-kolegjiun ashtu, që të mos paraqiten vonesa në shqyrtim të lëndëve;
- Fillohet me përdorimin e fletëshqyrtimeve gjatë shqyrtimit të lëndëve nga ana e zyrtarëve shqyrtues, me qëllim të lehtësimit të punës së tyre, si dhe ndarjes së përgjegjësisë;
- Po punohet në zgjidhje urbane të ndryshme, deri në miratimin e tyre;
- Po vazhdon publikimi i të gjitha lejeve të ndërtimit, të dhëna nga Sektori i urbanizmit, duke punuar me kronologji nga lejet më të fundit;
- Janë duke u identifikuar pengesat në zbatimin e planeve;
- Plani rregullues i hollësishëm " Mati 2 " - dërgimi në Kuvend për lenie në dispozicion për publikun.

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për periudhën raportuese.

4.1.3 Takimet me palë.

Kanë vazhduar takimet me palë, të martave dhe të enjteve, me përjashtime edhe ditëve të tjera, sipas nevojës.

5. Takimet me institucione të tjera

Edhe gjatë muajit shkurt, sikur edhe më herët, janë realizuar shumë takime me institucione qendrore - ministritë e linjës, si dhe organizata të huaja, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të ndryshme dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstytucional.

6. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

Në tabelë gjeni të dhënat për Sektorin e urbanizmit sa i përket kërkesave të pranuar, të përfunduara dhe në procedurë:

Lëndët e pranuar-janar	Të kryera-janar	Në procedurë-janar
104	82	165

Në numrin prej 82 lëndëve, 17 janë refuzime, të cilat bëhen në bashkëpunim me zyrtarët ligjorë, derisa janë kryer edhe shumë aktivitete në proces të përcaktimit të kushteve ndërtimore, si dhe lëshimit të lejeve të ndërtimit, që nuk mund konsiderohen si kryerje e lëndës, por aktivitete që ndikojnë në kryerje të lëndëve.

Në Sektorin e planifikimit: **47 lëndë të pranuar - të përfundura:**

- Informime - 7 lëndë;
- Informime nga Plani rregullues – 13 lëndë;
- Informime nga PZHU – 8 lëndë;
- Informime nga PZHK - 10 lëndë;
- Informime për parcializim – 8 lëndë;
- Bashkim të parcelave.

58 kërkesa online, informime nga plani - të përfunduara.

Në Sektorin e mjedisit: **8 lëndë të pranuar për leje mjedisore, 4 prej tyre të përfunduara.**

Spektori i Shërbimeve të përbashkëta:

- 32 kërkesa të pranuar dhe të përfunduara për qasje në dokumente zyrtare
- refuzime 21.

7. Takime të tjera

Gjatë këtij muaji, Spektori i urbanizmit ka realizuar shumë takime edhe me drejtoritë e tjera, si Drejtoria e Pronës dhe Financave, Drejtoria e Kadastrit dhe Drejtoria e Infrastrukturës, duke mos i lënë anash edhe takimet e shpeshta me Inspektoratin, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve.

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Sfidë për Sektorin e urbanizmit mbetet edhe ngarkesa me lëndë nga legalizimi, për objektet e papërfunduara, të regjistruara në regjistrin e ndërtimeve pa leje. Po ashtu, sfiduese paraqitet edhe zhvillimi i procedurës së pranimeve teknike, duke pasur parasysh vështirësitë në qasjen e lëndëve të mëhershme, si dhe bashkëpunimin me zyrtarë drejt zgjidhjes së problemit dhe caktimit të komisionit për pranim teknik. Po ashtu, mungesa e hapësirës për takime është një problem që ndikon në mbarëvajtjen e punës së mirëfillt.

9. REKOMANDIME - Shënimi rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

- Të mos përfshihen zyrtarët e Sektorit në komisione të ndryshme, ngaqë janë të ngarkuar me lëndë;
- Mbetet rekomandimi - të realizohen punët e nevojshme për sigurimin e një zyre, me tavolinë dhe karrige ekskluzivisht për takime - prezantime, duke siguruar pajisjet e nevojshme për të mundësuar punën drejtëpërdrejt në kompjuter, monitor dhe pajisjet përcjellëse për punë grupore;
- Të mundësohen trajnime ose vizita zyrtare të stafit, sa i përket procedurës për pajisje me leje ndërtimore, si dhe për regjistrimin, skedimin dhe arkivimin e dokumenteve.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Vazhdimi me shqyrtimin e lëndëve të bartura nga viti paraprak (aprovim, refuzim);
- Procedimi i lëndëve sipas afatit kohor të paraparë me ligj;
- Organizimi i takimit të punës për përfundimin e formave standarde të dokumenteve që lëshohen nga DUNMM-ja;
- Konsultime me palë në lidhje me projektet - në formë të shtypur në fleta A3 (para fazës së aplikimit për leje);
- Vazhdimi i plotësimit me informata të programit - Permit tracking system dhe organizimi i azhurnimit të të dhënave dhe publikimi i lejeve të lëshuara në ueb-faqe;
- Aktiviteti rreth avancimit të shërbimit të informimit të qytetarëve për procedurat e Urbanizmit;
- Vazhdimi i publikimit të lejeve të ndërtimit në ueb-faqe të Komunës;
- Miratimi dhe publikimi i taksës së ndërtimit, si dhe tarifave përkatëse;
- Vazhdimi i punës për ndërtimin e data-bazës në sistemin Gis;
- Analiza e PZHK- së dhe PZHU-së;
- Detyra projektuese për konkursin e zones " Qendra 1 dhe 2 " - " Qendra ";
- Aktivitete për shënimin e Ditës Botërore të Eficiencës së Energjisë, në bashkëpunim me INDEP dhe UNDP;
- Dita Botërore e Ujit, 22 Marsi;
- Gjatë muajit shkurt është planifikuar të behet përgatitja e tenderit për klasat verore , rregullimi i oborreve të shkollave, Qendrat e Mjekësisë Familjar;
- Diskutimi publik për rregulloren e taksave dhe tarifave për leje ndërtimore.

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme